VENDIM
Nr. 121, datë 13.3.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 760, DATË 19.12.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË, TË PRONËS ME NR. 98, ME EMËRTIMIN "GRUP DEPO (ISH-REPARTI USHTARAK NR. 5011)", DHE TË DISA SIPËRFAQEVE, TRUALL FUNKSIONAL DHE OBJEKTE, TË PRONËS NR. 109, ME EMËRTIMIN "SHA RIPARIM ARTILERIE", ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Mbrojtjes , Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 760, datë 19.12.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimin ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të disa sipërfaqeve, truall funksional dhe objekte, të pronës nr. 109, me emërtimin "Sh.a. Riparim artilerie", me vendndodhje në Brar, Tiranë.";

b) Në pikën 1 hiqen fjalët "... të pronës me emërtimin "Grup Depo (ish- Reparti Ushtarak nr. 5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe ...";

c) Në pikat 2 dhe 3, fjalët "... pronat e përcaktuara ..." zëvendësohen me "... trualli funksional dhe objektet e pronës nr. 109, të përcaktuara ...";

ç) Në pikën 4, fjala "... pronave ..." zëvendësohet me "... truallit funksional dhe objekteve të pronës nr. 109...".

2. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Mbrojtjes, të pronës nr. 98, me emërtimin "Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)".

3. Prona nr. 98, me emërtimin "Grup Depo (ish-Reparti Ushtarak nr. 5011)", i kthehet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama